

VENDIM
Nr. 687, datë 29.7.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR MBAJTJEN, PËRDITËSIMIN DHE
PUBLIKIMIN E STATISTIKAVE TË MBETJEVE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 60, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve që lidhen me krijimin, riciklimin, rikuperimin, eksportin dhe asgjësimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, sipas llojit, sasisë dhe përbërjes së tyre, të krijuara në territorin e njësisë së qeverisjes vendore që ato administrojnë.

3. Mbetjet e grumbulluara në mënyrë të diferencuar duhet të trajtohen referuar ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me qëllim mbledhjen e përpunimin e të dhënave prej tyre.

4. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe këto të dhëna ia dërgojnë këshillit të qarkut përkatës, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën/transportin brenda datës 31 janar, të çdo viti.

5. Mbështetur në vendimin nr. 1189, datë 18.11.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, ministria përgjegjëse për bujqësinë, ministria përgjegjëse për infrastrukturën/transportin, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për industrinë janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve, sipas shtojcës nr. 2, bashkë-lidhur këtij vendimi, dhe t’ia dorëzojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit brenda datës 10 shkurt të çdo viti.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mbledh, mban dhe përditëson statistikën për mbetjet sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në bazë të të dhënave të grumbulluara referuar pikave 4 e 5, të këtij vendimi, të cilat ia raporton ministrisë, brenda datës 28 shkurt të çdo viti.

7. Ministria përgjegjëse për mjedisin, në bazë të të dhënave të ardhura nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përgatit dhe publikon në variantin elektronik dhe në *website*-in e ministrisë raportin 3-vjeçar për statistikën e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilin ia vë në dispozicion publikut.

8. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për infrastrukturën / transportin, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për industrinë, ministria përgjegjëse për bujqësinë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, këshillat e qarqeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike nga data 1 janar 2019.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

¹Ky vendim, është përafshuar në mënyrë të pjesshme me rregulloren (KE) nr. 2150/2002 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 25 nëntor 2002, “Për statistikën e mbetjeve”; Nr. CELEX 32002R2150; Gazeta Zyrtare L 332, 09/12/2002, P.0001-0036.

FORMATI PËR RAPORTIMIN NGA AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT PËR MBETJET E KRIJUARA GJATË NJË
VITI NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tabela nr. 1

[illegible]

[illegible]

**FORMATI I RAPORTIMIT NGA AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT PËR LLOJET DHE SASITË E MBETJEVE TË
EKSPORTUARA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Tabela nr.3

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar të mbetjeve	Sasia totale e mbetjeve të importuara ton/vit	Sasia totale e mbetjeve të eksportuara ton/vit
Mbetje plastike	15 01 02 17 02 03		
Mbetje qelqi	15 01 07 17 02 02		
Mbetje metalike	15 01 04 17 04 07		
Mbetje druri			
Mbetje e letrës dhe kartonit	15 01 01 03 03 08		
Mbetje të baterive të dala jashtë përdorimit	16 06		
Mbetjetë gomave të dala jashtë përdorimit	16 01 03 40040000		
Mbetje të produkteve të tekstilit	04 15 09 04		
Mbetje të vajrave të përdorura kg/ton vit	12 01 06* 12 01 10*		
Mbetje vajrash izoluese dhe përcjellëse nxehësie që përbëjnë PCB/PCT	13 03 01*		
Mbetje farmaceutike	07 05 13* 07 01 02*		
Mbetje nga plehurat kimike dhe pesticideve të skaduar nga përdorimi në bujqësi kg/ton vit	20 01 19*		
Mbetje elektrike dhe elektronike kg/ton vit	16 02 20 01 36		

FORMATI PËR RAPORTIMIN E MBETJEVE NGA MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR BUIQËSINË NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË MJEDISIT

Tabela nr.3

[illegible]

FORMATI PËR RAPORTIMIN E MBETJEVE NGA MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR INDUSTRIJË AGJENCINË
KOMBËTARE TË MJEDISIT

Tabela nr.4

[illegible]

SHTOJCA NR.3

FORMATI PËR RAPORTIMIN E MBETJEVE NGA NJËSIA E PUSHITETIT VENDOR, QARKU _____

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar	Bashkia	Bashkia	Bashkia
Niveli i banorëve				
Sasia e mbetjeve për person kg/vit				
Sasia e mbetjeve shtëpiake kg/ton vit	20			
Sasia e mbetjeve të qelqit kg/ton vit	17 09 04			
Sasia e mbetjeve shtetërore kg/ton vit	18 01 10			
Sasia e mbetjeve shtetërore kg/ton vit	17 02 03			
Sasia e mbetjeve plastike kg/ton vit	15 01 02			
Sasia e mbetjeve të qelqit kg/ton vit	15 01 07			
Sasia e mbetjeve metalike kg/ton vit	17 04 07			
Sasia e mbetjeve të drurit ton/m³	15 01 04			
Sasia e mbetjeve të drurit ton/m³	17 02 01			
Sasia e mbetjeve të letës dhe kartonit kg/ton vit	15 01 03			
Sasia e mbetjeve të baterive të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	15 01 01			
Sasia e mbetjeve të baterive të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	03 03 08			
Sasia e mbetjeve të baterive të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	16 06			
Sasia e mbetjeve të baterive të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	16 06 01*			
Sasia e mbetjeve të baterive të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	16 06 06*			
Sasia e mbetjeve të gomave të dala jashtë përdorimit kg/ton vit	16 01 03			
Sasia e mbetjeve të vajrave të përdonura kg/ton vit	400400 00			
Sasia e mbetjeve të vajrave të përdonura kg/ton vit	12 01 06*			
Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve kg/ton vit	12 01 10*			
Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve kg/ton vit	02 01 02			
Sasia e mbetjeve të produkteve të tekstilit kg/ton vit	04			
Sasia e mbetjeve të produkteve të tekstilit kg/ton vit	15 09 04			
Sasia e mbetjeve elektrike dhe elektronike kg/ton vit	16 02			
Sasia e mbetjeve të depozituara në landfill ton/vit	20 01 36			
Sasia e mbetjeve të depozituara në incinerator ton/vit				

